

Sinjalizim për sigurinë publike / postim në ueb faqe:

Novo Nordisk është vënë në dijeni për disa lapsa Ozempic® dhe Saxenda® në Republikën e Kosovës që janë falsifikuar dhe nuk janë produkte legjitime. Produktet e falsifikuara janë shitur si brenda zinxhirit të ligjshëm të furnizimit ashtu edhe në atë të paligjshëm. Përmbajtja e lapsave të falsifikuar është krejtësisht e ndryshme nga produktet origjinale dhe nuk duhet të përdoret pasi që lapsat e falsifikuar përbëjnë rrezik për sigurinë e pacientëve.

Lapsat origjinalë Novo Nordisk Ozempic® dhe Saxenda® nuk zgjaten ose rriten në gjatësi kur vendoset doza. Rrotulluesja e dozimit është me doza fikse, si p.sh. .25 mg, .5 mg dhe 1.0 mg për Ozempic® dhe .6 mg, 1.2 mg, 1.8 mg për Saxenda®.

Një laps i falsifikuar mund të identifikohet në bazë të shkallëzimit që shkon nga 0 në 80 njësi dhe që del nga lapsi kur vendoset doza.



Example 1: Genuine Ozempic® pen



Example 2: Genuine Saxenda® pen



Example 3: Falsified Ozempic® pen

Shembull 1: laps origjinal Ozempic®

Shembull 2: laps origjinal Saxenda®

Shembull 3: Laps i falsifikuar Ozempic®

Veprime për pacientët:

- Duhet të jeni të vetëdijshëm për riskun e produkteve të falsifikuara dhe ta kontrolloni produktin tuaj me kujdes përpara se ta përdorni.
- Nëse zbuloni një produkt të falsifikuar, mos e përdorni atë dhe ju lutemi të kontaktoni Novo Nordisk Pharma Operations A/S Dega në Kosovë.
- Nëse keni përdorur një produkt për të cilin dyshoni se është i falsifikuar, kërkoni menjëherë këshilla mjekësore.

Siguria e pacientëve është prioritet kryesor për Novo Nordisk dhe jemi në dialog të ngushtë me të gjitha palët e interesit për t'i mbështetur pacientët në mënyrën më të mirë të mundshme nga produktet e falsifikuara.

Nëse keni ndonjë pyetje, ju lutemi të kontaktoni Novo Nordisk Pharma Operations A/S Dega në Kosovë:

E-mail: koprsecurity@novonordisk.com

Telefon: +383 38725681

